



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 26, datë 16/05/2022

PËR

DHËNIEN E TITULLIT “DOKTOR HONORIS CAUSA”
Z. ALBERT PAPARISTO”

Bazuar në ligjin nr 80/2015 “Pët atsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nen 3, 38, VVM Nr.112, date 23/02/2018 “Per përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujeve akademikë “Profesor i asociar” dhe “Profesor”, Kreu i V-të (Dispozita të fundit dhe kalimtare) pika 1, Statutin të UART (Funksionet e Senatit Akademik të UART) nen 24, gërmë ff, si dhe në propozimin e Fakultetit të Muzikës Nr. Prot 186., datë 16/05/2022, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Të japë titullin “Doktor Honoris Causa” për zotin Albert PAPARISTO me motivacionin: “Pedagog dhe themelues i KONSERVATORIT SHTETËROR TË TIRANËS, si dhe Drejtor i parë i këtij konservatori. Themelues i Muzikologjisë Shqiptare, me kontribut të madh e të jashtëzakonshëm në shkollën e parë shqiptare për muzikën, si dhe shembull për të rinjtë që kanë zgjedhur tëjenë e nesërmja e muzikës shqiptare”;
2. Të caktojë reçëntë Prof. Dr. Zana SHUTERIQI/PRELA dhe Doc.Dr. Holta SINA;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Adresa: Blv. “Deshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 225 488, www.uitart.edu.al

Faqë1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LILOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Ervin DULI (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANI**

Nr. 1000020X
16/05/2022

Tiranë, më 16.05.2022

Nr. 186 prot.

I. Lënda: Propozim mbi dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" z. Albert Paparisto

Drejtuar: Senatit Akademik të UART

Inderuar Kryetar i Senatit Akademik të UART Prof. Kastriot ÇAUSHI

Të nderuar anëtarë të Senatit Akademik të UART,

Fakulteti i Muzikës në kuadër të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës dëshiron të vlerësojë dhe të shprehë mirënjojen ndaj stafit akademik, tashmë të dalë në pension, i cili përfaqëson vlera të jashtëzakonshme përsa i përket kontributit institucionalo-pedagogjik, artistik dhe atij shkencor.

Bazuar në propozimin e Departamentit KMDP si dhe vlerësimet e muzikologeve Prof. Dr. Zana Shuteriqi dhe Dr. Holta Sina propozojmë vlerësimin me titullin "Doctor Honoris Causa" të z. Albert Paparisto.

Z. Albert Paparisto është ndër të paktat personalitete të muzikës shqiptare me një kontribut të jashtëzakonshëm dhe të gjithanshëm në jetën kulturore të vendit.

Kontributi i tij shtrihet në fushën mësimdhënies si pedagogë për një periudhë gati 40-vjeçare pranë Akademisë së Arteve, kontribut institucional si si themeluesi dhe drejtori i parë i Konservatorit Shtetëror të Tiranës (1962), drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit, drejtiesit i sektionit të muzikës pranë Lidhjes së Shkrimitarëve dhe Artistëve etj.

Kontributi shkencor i zotit Paparisto është i një rëndësie të veçantë, si dhe themelues i muzikologjisë shqiptare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ai merr pjesë në ekspeditës së patë, shqiptaro-gjermane.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë propozimet e kolegëve të Fakultetit të Muzikës, si dhe curriculum vitea të Albert Paparisto.



Prof. Dr. Isak SHEHU

Dekan i Fakultetit të Muzikës





**UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEPARTAMENTI KMDP**

Nr. 185 prot.

Tiranë, më 14.05.2020

Lënda: Mbi dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa” z. Albert Paparisto

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Muzikës

**Prof. Dr. Isak Shehu
Universiteti i Arteve
Sheshi Nënë Tereza**

Inderuar z. Shehu

Nisur nga aktivitetet e shumta që po zhvillohen për të krejtuar 60 vjetorin e themelimit të Fakultetit të Muzikës, Njësia Bazë KMDP dëshiron të vlerësojë dhe të shprehë mirënjojen ndaj stafit akademik, tashmë të dalë në pension, i cili përfaqëson vlera të veçanta përsa i përket kontributit institucionalo-pedagogjik, artistik dhe atij shkencor.

Bazuar në propozimet e muzikologeve Prof. Dr. Zana Shuteriqi dhe Dr. Holta Sina propozojmë vlerësimin me titullin “Doctor Honoris Causa” të z. Albert Paparisto.

Z. Albert Paparisto është ndër të paktat personalitete të muzikës shqiptare me një kontribut të jashtëzakonshëm dhe të gjithanshëm në jetën kulturore të vendit.

Pikë së pari ai njihet si themeluesi dhe drejtori i parë i Konservatorit Shtetëror të Tiranës (1962), detyrë kjo që ju besua përgjatë kohës kur drejtonte edhe Teatrin e Operas dhe Baletit. Për më tepër, kontributi i tij institucional materializohet në një sërë institucionesh të tjera sikurse është edhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve. Në periudhën 1956-1958 z. Paparisto kryen detyrën e drejtuesit të sektionit të muzikës pranë këtij institucioni shumë të rëndësishëm për kohën. Përfaqëson Shqipërinë, në cilësinë e sekretarit të muzikës, në





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Kongresin e II të kompozitorëve sovjetikë të mbajtur në Moskë në 1956, sikurse dhe realizon, për herë të parë, panoramën e plotë të zhvillimeve të muzikës shqiptare në Kongresin I të Shkrimtarëve dhe Artistëve në 1957.

Gjithashtu një kontributë i pazëvendësueshëm z. Paparisto i atribuohet në lidhje me drejtimin e Teatrit të Operas dhe Baletit (1958-1962). Pikërisht gjatë drejimit të tij TOB pati një rritje të ndjeshme të aktiviteteve dhe cilësisë interpretative sikurse dhe zgjerim të repertorit. Përpos repertorit të operave ruse, rëndësi e veçantë iu dha vënies në skenë edhe operave të tjera të repretorit botëror si “Berberi i Seviljes” (Rosini), “Madama Buterflaj” (Puccini), “Don Paskuale” (Donizeti), “Paliaçot” (Leonkavallo), “Karmen” (Bize) etj. Njëherazi, pikërisht në këtë institucion, Paparisto vendos edhe standartin e promovimit dhe mbështetjes së krijimtarisë muzikore të kompozitorëve shqiptarë nëpërmjet vënies në skenë të një sërë veprash si “Mrika” (Prenkë Jakova), “Lulja e Kujtimit” (Kristo Kono), “Pranvera” (Tish Daija) etj.

Për tu kthyer tashmë tek themelimi i Konservatorit Shtetëror, i cili nisi aktivitetin e tij më 15 Janar 1962, nën drejtimin e Albert Paparistos. Me themelimin e Konservatorit Shtetëror, Paparisto nuk kontribuoi vetëm në formimin dhe edukimin muzikor por edhe në jetën artistike të vendit, qëkurse pikërisht artistët e formuar në këtë institucion do të bëhen në pjesë e orkestrave simfonike, insitucioneve kulturore në Tiranë dhe rrëthe sikurse dhe do të siguronin vazhdimësinë e jetës kulturore në Republikën e Shqipërisë. Ndoshta vetëdija mbi përgjegjësinë e detyrës së re ndikoi në vendimin e Paparistos për të hequr dorë nga të gjitha detyurat e tjera dhe ti përkushtohej në vazhdimësi punës në Konservatorin Shtetëror. Kontributi i tij në këtë institucion ishte i gjithanshëm si personi mbi të cilin binte përgjegjësia kryesore për programet mësimore, *curricula-t* e të gjitha lëndëve të hartuara prej tij apo pedagogëve të tjera, modeli i shkollës etj. Mësimdhënia e z. Paparisto në këtë institucion mbulon lëndët e teorisë së muzikës dhe analizës së formës por gjithsesi ai tregohet mjaft aktiv edhe ndaj lëndëve qëkurse nën varësinë e drejtpërdrejtë të tij ishin edhe klasat e dirizhimit dhe kompozicionit.





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Albert Paparisto ka një kontribut të vyer edhe nëpërmjet krijimtarisë së tij muzikore.

Panvarësish se formimi i tij, nuk ishte ai i një kompozitori, Paparisto karakterizohet nga një talent i veçantë dhe sigurisht që formimi i tij teorik, ka ndihmuar mjaftueshmë në konkretizimin e talentit të tij të lindur.

Kompozon kryesisht vepra të muzikës së dhomës, ndërkoq që një pjesë e tyre, për vlerat artistike dhe pedagogjike, janë bërë tashmë pjesë e repertorit të shkollave tona sikurse është edhe Romanca për violinë e piano. Krijimtaria muzikore e Paparistos përfshin atë vokale me vepra për vokal dhe shoqërim instrumental sikurse dhe për kor acapella, gjininë instrumentale sikurse janë veprat për piano si Toccatina, Pjesë lirike, Marsh, Çiftelia, Balladë etj dhe atë të muzikës instrumentale të dhomës si Romance për violinë dhe piano, "Kang' e lashtë" për oboe dhe piano, "Arieta" për flaut dhe piano, "Duo polifonike" për klarinet e fagot etj.

Njëherazi Paparisto ka kompozuar edhe një koncert për violinë dhe orkestër për klasat e treta fillore, çka nënvijëson kontributin e tij pedagogjik edhe për fëmijët e angazhuar në mësimin e instrumentave muzikore.

Përpos sa më sipër Albert Paparisto ka një kontribut të vyer në fushën e studimeve mbi muzikën. Paparisto njihet si themeluesi i muzikologjisë shqiptare. Aktiviteti i tij shkencor dhe kritik shtrihet në një periudhë 40 vjeçare 1950-1990. Shkrimet e tij, kryesisht, publikohen në shypin e kohës si në gazeten "Drita" dhe revistën "Nëntori". Për më tepër, një pjesë e veprimtarisë së tij shkencore materializohet në botimet universitare si në realizimin e disa kapitujve për tekstin e historisë së muzikës shqiptare botuar në 1983, shkrimin e kapitullit rreth dramaturgjisë dhe formave muzikore të operës në tekstin e Analizës së Veprave Muzikore etj. Ai njihet si anëtar, përfaqësues i shtetit shqiptar së bashku me Ramadan Sokolin, i ekspeditës së parë, shqiptaro-gjermane, të plotë për dokumentimin e muzikës tradicionale shqiptare, e iniciuar nga Erich Stockmann e cila u mbajt në periudhën Maj-Korrik 1957. Falë kësaj ekspedite, për herë të parë, u bë e mundur njohja dhe dokumentimi i muzikës tradicionale përgjatë gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me sa më sipër, dëshirojmë të propozojmë vlerësimin e z. Albert Paparisto me titullin "Doctor Honoris Causa"

Prof. Asoc. Dorian Çene

Përgjegjës i Njësisë Bazë KMDP



Propozim për dhënien e titullit "Honoris Causa" zotit Albert Paparisto

Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela
Rruga Gregor Heba, P. 45/1, Sh. 2, Ap. 31, Tiranë
Tel. 069 407 4520
Mail: zanaprela53@gmail.com

Drejtuar:

Tiranë, 14. 05. 2022

Departamentit KMDP

Fakulteti i muzikës

Eshlë në ndeshmum të t'ju parashitoj këtë kërkesë për dhënien e titullit "Honoris Causa" zotit Albert Paparisto, një ndër figurat më të rëndësishme të botës muzikore shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX, ndër themeluesit e Konservatorit Shtetëror të Tiranës dhe drejtor i parë i këtij institucioni të krijuar në vitin 1962.

Kërkesa mban parasysh si më poshtë:

- Kontributin e shquar të z. Paparisto në lindjen dhe përparimin e arsimit të lartë muzikor shqiptar, me një vizion të qartë perspektiv për zhvillimin e mëtejshëm të tij në kuadrin përgjithshëm të rritjes së sistemit universitar të vendit.
- Rolin e rëndësishëm që ai luajti në mendimin muzikor teorik shqiptar si një ndër zërat më autoritarë të tij për një periudhë rrëth 30-vjeçare.
- Drejtimin dhe formimin me baza të shëndosha profesionale të dhjetra studjueve të fushave akademike dhe të kërkimit shkencor, ndër të cilët figura përfaqësuese të rrafshit etnomuzikologjik, historiografik dhe etestik muzikor.
- Formimin e dhjetra drejtuesve e punonjësve të lëvizjes muzikore amatore shqiptare, të shpërndarë në qendra dhe shtëpi kulture në mbarë vendin.
- Krijimin e një trashëgimie muzikore të fushave të muzikës instrumentale dhe vokale, e cila mbetet pjesë e rëndësishme e repertorit muzikor tradicional kombëtar, gjithashtu e përfshirë edhe në planet mësimore të programeve përkatëse të Fakultetit të muzikës në Universitetin e Arteve.

Me respekt,

Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prela



Dr. Holta Sina Kilica

Rr. "Shyqyri Brari", P. 3. Ap.16, Tiranë

Cel 0684010624

e-mail: sinaholta@yahoo.com

Propozim për dhënien e titullit "Honoris Causa" z. Albert PAPARISTO

Drejtuar:

Departamentit KMDP, të Fakultetit të Muzikës në UA

Tiranë, 12.05.2022

Jam e nderuar që më jepet mundësia t'ju parashtroj kërkesën time për dhënien e titullit "Honoris Causa" z. Albert Paparisto, një prej themeluesve të Konservatorit Shtetëror të Tiranës, drejtor i parë i tij (në vitin 1962) si dhe një prej personaliteteve më të rëndësishëm të artit muzikor shqiptar. I diplomuar shkëlqyer në Konservatorin e Moskës "P. I. Çajkovski" për teoritikë (muzikologji) në drejtimin e kompozitorit të madh D. Shostakoviç, ai së bashku edhe me figura të tjera të ndritura si Ç. Zadeja, T. Harapi, K. Lara, T. Daija etj., u bënë promotorët e arsimit të lartë muzikor dhe korifejtë e zhvillimeve muzikore në vend.

Paparisto ka një kontribut të çmuar së pari në hartimin e plan-programeve mësimore veçanërisht për lëndët teorike (në një kohë kur çdo lëndë niste për herë të parë në Konservator).

Atij i takon dhe merita e hedhjes së bazave fillestare të bibliotekës së Konservatorit, pasi transferoi në të bibliotekën dhe fonontekën e tij personale, për t'ju ardhur në ndihmë studentëve dhe pedagogëve.

A. Paparisto është gjithashtu themeluesi i katedrës së teorikut (sot e muzikologjisë), ku nën drejtimin e tij janë diplomuar një numër i konsiderueshëm studentësh që do të lëvronin më pas



me sukses fushat e mësuesisë, kërkimit shkencor e drejtimit në pozicione të ndryshme të jetës artistike e kulturore të vendit. Ai ka qenë për vite me rradhë pedagog titullar i lëndeve harmoni dhe analizë e formave muzikore.

Vëprimtaria e tij para viteve '90 te shek XX, u lidhi ngushtë veçanërisht me mendimin teorik, kritikën e publicistikën; ai ka qenë një prej personaliteteve më aktivë e mendjëmprethë që ka lënë gjurmë me referimet e artikujt e tij në konferencat dhe shtypin shqiptar të asaj kohe, por dhe në tryeza të ndryshme diskutimesh konstruktive për artin muzikor shqiptar, ku mendimi i tij kishte një peshë të padiskutueshe.

Gjithashtu kontributi i tij shtrihet edhe në fushën e krijuarit muzikore, konkretisht në atë instrumentale e vokale, me vepra të cilat kanë hyrë me dinjitet në repertorin muzikor kombëtar dhe interpretohen edhe sot jo vetëm nga muzikantë shqiptarë, por dhe te huaj.

Për të gjitha këto vlera të parashtrua më sipër, për këtë personalitet dhe autoritet të shkollës dhe artit muzikor shqiptar, dëshiroj që propozimi im të merret parasysh.

Me respekt,

Dr. Holta Sina Kilica

Muzikologe, pedagoge në UA



CURRICULUM VITAE

e

Albert Paparisto

Emri : Albert

Mbiemri : Paparisto

Vendlina : Elbasan

Datëlindja 21.10.1925

Data e vdekjes – Detroit – USA 02.11.2014

Arsimimi:

1943 - Përfundon shkollën Normale të Elbasanit

1951-1956 - Përfundon studimet e e lartë në Konservatorin “Çajkovskij” Moskë – Rusi për Teoritik (Muzikologji)

Punësimi:

1945-1951 – Punonjës në aparatin e KQ të PPSH dhe Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës

1956-1958 – Sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve

1958-1962 – Drejtorit i Teatrit të Operas dhe Baletit

1962-1966 – Drejtor i TOB dhe Konservatorit Shtetëror të Tiranës

1966-1970 – Shef i muzikës dhe drejtor në Shtëpinë e Kulturës Shkodër

1970-1971 – Drejtor i shkollës së mesme artistike “Prenk Jakova” Shkodër



1971-1995 - Pedagog në Fakultetin e Muzikës në Akademinë e Arteve Tiranë

1995 – Del në pension

1995-1999 – Pedagog me kohë të pjesëshme në FM në AA

1999-2015 – Emigron në USA

Krijimtaria Muzikore:

1960-2000 – Ka kompozuar rrith 23 miniatura instrumentale

1966-1985 – Album me krijime për piano

1966-1985 – Album me pjesë për violonçel & piano

1968 - “Liria” (Romancë për zë & piano)

1969 - “Romancë” (Për zë & piano)

1969 - “Nocturn (Për violin & Piano)

1970-1975 - Romancat vokale

1. Hëna (Për Soprano & Piano)

2. “Ra një Yll përmbi brezare” (Për Soprano & Piano)

3. “Midis ballit më ke një pikë” – Mbështetur në këngën qytetare shkodrane me të njëjtin titull (Për Soprano & Piano)

1975 - “Në syrin e pranverës” (Romancë për zë & piano)

1978 - “Romancë” (Oboe & Orkestër)

1983 - “Romancë” (Violinë & Orkestër)

1989 - “Rondo (Violinë & Piano)

2004 - Boton 3 Albume me krijimtari muzikore



1. “Album me 12 Pjesë instrumentale”
2. “Album me 13 Pjesë Pianistike”
3. “Album me 14 Pjesë përi Zë & Piano”


Albert Paparisto ka kompozuar kryesisht vepra të muzikës së dhomës për zë dhe instrumente te ndryshëm. Krijimtaria e tij shquhet për artikulim të qartë, frysme kombëtare dhe emocionalitet. Krahas vlerave të spikatura artistike, krimjtarë muzikore e Paparistos pasqyron kulturë dhc njohje të thellë të artit muzikor. Veprat muzikore e Paparistos është jo vetem pjesë e programeve mësimore të arsimit muzikor, por është prezente gjithashtu në dhjetëra veprimtari muzikore në repertorin aktiv të instrumentistëve shqiptarë brenda e jashtë vendit.

Veprimtaria muzikologjike, shkencore, kritike dhe publicistike:

Në harkun kohor 1956-2000 Albert Paparisto ka qënë sistematikisht i pranishëm në shtypin e shkruar dhe në median audiovizive me artikuj problemorë, kritikë e publicistikë muzikore, biseda e emisione që kanë pasur në focus problematikat dhe zhvillimet e muzikës sonë kombëtare. Shkrimet e tij dallohen për mprehtësi shkencore e autoritet profesional. Në shtypin shqiptar ato janë të panumërtë.

Albert Paparisto është një nga pjesëmarësit më aktivë në të gjitha ngjarjet shkencore në vend si simpoziume, konferenca, kongrese etj. Me kumtesa e referateve mbi problematika të artit muzikor shqiptar. Shkrimet e tij kanë zënë vend e janë të pasqyruara në të gjitha organet e shtypit shqiptar. Ai është një nga personalitetet e shquara që ka ndikuar në vijëmësi thellësisht në formimin e zhvillimin e jetës muzikore shqiptare të kohës.

Krahas sa më sipër, Albert Paparisto ka merita të veçanta si nismëtar dhe promovues i arsimit të lartë muzikor në Shqipëri. Eshtë një ndër themeluesit e Konservatorit Shtetëror të Tiranës dhe drejtor i këtij institucionit autoritati



programeve mësimore të lëndëve bazë të arsimit të lartë muzikor (Harmoni, Analizë forme, Seminare kritike, Muzikologji etj), themelues i shkollës muzikologjike shqiptare.

